



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa Abdi Toptani”, nr.1, Tiranë

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. Prot.

Tiranë, më / /2018

**V E N D I M**

**Nr. 187, Datë 12/12/ 2018**

**PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUA NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE**  
**TË APELIT, TIRANË**  
**për periudhën 01.01.2017 deri në 30.10.2018**

Nga auditimi i ushtruar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, pwr periudhën 01.01.2017 deri më datën 31.10.2018 me objekt “*Mbi auditimin e pasqyrave financiare vjetore të institucionit*”, për periudhën 01.09.2017 deri në 31.10.2018, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë jo materiale për të cilën japim opinion të pakualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Departamenti Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit financiar “*Mbi auditimin e pasqyrave financiare vjetore të institucionit*” të ushtruar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë sipas programit të auditimit nr. 1200/1 prot, datë 31.10.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.10.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

**A. OPINIONI I AUDITUESIT.**

### ***Baza për opinionin:***

KLSH ka audituar veprimtarinë e Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë (GJAAT) në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ISSAI 1700<sup>1</sup>, dhe ISSAI 1200<sup>2</sup>, si dhe në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Menaxhimi i GJAAT është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Përgjegjësia e auditimit është të shprehet për rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se, aktiviteti është kryer në përputhje me kuadrin rregullativ dhe se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

### ***I. Opinion mbi auditimin e pasqyrave financiare.***

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga Gjykata Administrative e Apelit, Tirane të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti është paraqitur në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar në të gjitha aspektet materiale, kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyra e performancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, pasqyrën e amortizimit të aktiveve, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, pasqyrat financiare, deklaratat e të ardhurave, e shpenzimeve, banka janë përfshirë në deklaratat financiare. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pakualifikuar për periudhën ushtrimore 01.01.2017-31.10.2018.

### ***Opinionin i auditimit:***

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e mësipërme, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë në datën 31 dhjetor 2017 për të cilën ***japim opinionin të pakualifikuar***<sup>3</sup>.

## **B. MASA ORGANIZATIVE:**

<sup>1</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>2</sup> Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

<sup>3</sup> Një opinion i pakualifikuar jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit u konstatua se të gjitha pajisjet kompjuterike, që nga momenti i regjistrimit të tyre në “Alpha web” janë keq-klasifikuar, por pa ndikim material në rezultatin e pasqyrave financiare. Të gjitha pajisjet elektronike ishin klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune” në mospërputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2016 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” i ndryshuar, Kapitulli V, pika 3 “Lista e llogarive”, ku është për caktuar që këto asete i përkasin llogarisë 218 “Inventar ekonomik”. *Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 7-25 të Raportit të Auditimit.*

#### **1.1 Rekomandimi:**

Dega e buxhetit në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë në bashkëpunim me ZABGJ dhe subjektin e mirëmbajtjes së sistemit “Alpha web”, të marrin masat për të analizuar zë për zë këto llogari dhe më pas të bëhet sistemim i tyre, duke bërë kalimin e shumave nga një llogari në tjetrën, me qëllim paraqitjen sa më të saktë të zërave të pasqyrës financiare për vitin 2018.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi u konstatua se, Sistemi i Drejtësisë është ende në proces reformimi, në pritje të krijimit të institucioneve ligjore të reja, sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, si rrjedhim Gjykata Administrative Apelit-Tiranë është në përshtatshmëri të veprimtarisë së saj me frymën e reformës në drejtësi. Pikërisht mos krijimi i Këshillit të Lartë të Gjyqësorit (KLGJ), ka sjellë, mosplotësimin e shtesës organike të strukturës me nëpunësve civilë gjyqësor dhe me punonjës të strukturës administrative, e cila është domosdoshmëri absolute, për kushtet dhe natyrën e punës në GjAA-Tiranë.

Konkretisht, si pasojë e fluksit të regjistruar të çështjeve administrative për gjykim si dhe të gjykuara deri në momentin e hartimit të këtij materiali, u konstatua ngarkesë voluminoze së punës së gjyqtarëve (70 dosje në muaj), rrjedhimisht është i nevojshëm dhe i domosdoshëm shtimi i organikës me sekretarë gjyqësor.

Sa më sipër, pavarësisht miratimit të reformës në drejtësi, Gjykata Administrative e Apelit-Tiranë, si gjithë gjykatat e çdo niveli në Shqipëri, kanë operuar me aktet ligjore/nënligjore të mëparshme, ku Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ), vazhdon të kryej funksionet e mëparshme, sipas vendimeve të Bordit Drejtues të saj.

Në lidhje me problematikën e evidentuar më sipër, nga GjAA-Tiranë, është kërkuar pranë ZABGJ-së me shkresë nr. 181 prot datë 05.04.2017, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE)-së, pranë Ministrisë së Drejtësisë me shkresë nr. 488 prot datë 27.10.2017, me objekt “Mbi shtimin e organikës dhe strukturës së administratës gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit”, kërkesë e cila nuk është miratuar, pasi nuk janë miratuar fonde buxhetore në lidhje me problematikën e plotësimit të strukturës. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 25-31 të Raportit të Auditimit*

#### **2.1 Rekomandimi:**

Nga ana e GjAA-Tiranë me ZABGJ-në (deri në momentin e krijimit të KLGJ), në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me Ministrinë e Drejtësisë, të gjendet mundësia e dhënies së fondeve buxhetore për shtimin e strukturës organike me sekretarë gjyqësorë dhe punonjës të strukturës administrative, në mënyrë që të sigurohet pavarësia e gjyqësorit, duke iu përgjigjur në kohë gjykimin e çështjeve administrative në përputhje me bazën ligjore.

*Vazhdimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, institucioni gjyqësor për punonjësit administrativ të GjAA-Tiranë, vepron dhe realizon detyrat e tyre, në mungesë të një

Rregullores së Brendshme, e cila sipas ligjeve nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” është përcaktuar se, është kompetencë e KLGJ që do të miratojë rregulloren të funksionimit të gjykatave e cila do të jetë unike për të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë.

Në këto kushte, nuk është hartuar një dokument i tillë, pasi me ndryshimet ligjore të reformës në drejtësi, kryetari i Gjykatës së GJAA-së, nuk ka një kompetencë për të miratuar rregullore të brendshme si një akt nënligjor me karakter normativë, pasi kjo tashmë kjo është kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë e cila në bashkëpunim me strukturën ndërkombëtare Euralius 5, është ngritur një grup pune, për Draf-Rregullore, e cila do të miratohet me pas nga Këshilli i Lartë Gjyqësorit(KLGJ). *Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 25-31 të Raportit të Auditimit*

### **3.1 Rekomandimi:**

Nga ana e institucionit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit-Tiranë, për aspekte të veprimtarisë ku do jetë e nevojshme për të përmbushur rregullat e përgjithshme të administrimit dhe menaxhimit financiar, të veprohet me nxjerrjen e urdhrave përkatës sipas nevojave që do të lindin në praktikën e përditshme të veprimtarisë të gjykatës në përputhje me bazën ligjore respektive, deri në momentin e krijimit të KLGJ.

**Vazhdimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i transaksioneve të procedurave blerje e vogël u konstatua se, kryetarja e Degës së Buxhetit që është njëkohësisht dhe nëpunëse zbatuese është anëtare e komisionit të blerjeve të vogla dhe anëtare e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve. Në këtë rast kryetarja e degës së buxhetit, duke qenë pjesë e këtyre komisioneve ri-kontrollon procedurat e realizuara nga vetë nëpunësi, kjo në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*” pika 52-54, ku është e përcaktuar, që nëpunësi zbatues ka për detyrë kontrollin e procedurave nga pikëpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve të realizuara.

Gjithashtu nga auditimi i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të magazinës u konstatua se, dokumentacioni i magazinës përpilohet nga arshivistja, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga kryetarja e degës së buxhetit (NZ), veprime këto në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 pika 15, ku thuhet se: “Nëpunësi i ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë nuk duhet të ngarkohet me detyrën e arkëtarit dhe/ose të magazinierit”. si dhe pika 40, ku citohet se “...është magazinieri që regjistron veprimet në kartelat e magazinës të lëvizjeve përkatëse të aktive në sasi dhe në vlerë..”. *Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 7-25 të Raportit të Auditimit.*

### **4.1 Rekomandimi:**

ZABGJ në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me Ministrinë e Drejtësisë, e cila miraton dhe struktura e gjyqësorit, të marrin masa për shtimin në strukturë të GJAAT të një specialisti finance, me qëllim mirëfunksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të të gjitha transaksioneve financiare.

*Vazhdimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Me urdher nr. 2711/1, datë 19.09.2017 të Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) znj. F, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i është akorduar leje për tu shkëputur nga puna nga data 01 Tetor 2017 deri në 01 dhjetor 2017, për arsye studimore me stazh profesional në Francë. Sipas këtij urdhri, kjo leje e përkohshme e shkëputjes nga puna por e papaguar është mbështetur në Vendimin i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 35, datë 17.07.2017 “*Për dhënien e Lejeve të papaguara gjyqtarëve*”. Në zbatim urdhrin të Kryetarit të KLD, Gjykata Administrative e Apelit, me të drejtë nuk i ka

paguar pagën e znj. P..., pasi gjatë kësaj periudhë, kjo gjyqtare ka qenë për studime në Francë për të cilën ka marrë edhe leje të papaguar nga Kryetari i KLD me urdhrin e sipërcituar. Mirëpo, për këtë mos pagesë znj. P..... i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë për të paditur Gjykatën Administrative të Apelet dhe ka kërkuar pagesën e pagës së bashku me kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërorë e shëndetësore dhe pensionin suplementar, për periudhën 01 Tetor 2017 deri në 01 dhjetor 2017.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë ka marrë vendimin që Gjykata Administrative e Apelet, duhet ti paguaj znj. P....., të gjitha këto detyrime që lindin nga punësimi, për periudhën 01 Tetor 2017 deri në 01 dhjetor 2017. *Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 34 të Raportit të Auditimit*

#### **5.1 Rekomandimi:**

Gjykata Administrative e Apelet, Tiranë duhet të njoftojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe të ndjek të gjitha shkallët e tjera të Gjykimit, për të bërë të mundur mospagimin e këtyre detyrimeve të padrejta, për të eliminuar kështu, kostot buxhetore të tepërta që shkojnë në dëm të buxhetit të shtetit.

*Menjëherë*

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.*

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**